



Nr.3

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR

KLIMATIK

Mars 2017



Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2017



BULETINI MUJOR

KLIMATIK

Muaji: Mars Viti 2017


Nr. 3

Vlerësimi meteorologjik për muajin mars 2017

Në dekadën e parë muaji Mars ka qenë i ndikuar nga një sistem ciklonar, i cili ka gjeneruar reshjet kryesore në 3-4 ditë në pjesën më të madhe të vendit.













Më pas vendi ynë është ndikuar nga një sistem anticiklonar, duke krijuar një atmosferë të qëndrueshme. Në qarkullimin e saj ajo ka sjellë masa ajrore të ngrohta, duke rezultuar në një mot të thatë dhe me temperatura relativisht të larta.

Një pamje tipike e situatës sinoptike mbizotëruese gjatë këtij muaji jepet në figurën në vijim (datë 15 mars 2017).



Për një informacion më të detajuar ditore mund të konsultoni dhe Buletinin Ditore Meteorologjik të përgatitur nga Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të IGJEUM.

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet në disa prej vendmatjeve meteorologjike të **Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik** për muajin mars 2017.




KARAKTERISTIKAT KRYESORE KLIMATIKE TË MUAJIT: MARS

Bazuar në të dhënat e muajit mars 2017 dhe krahasuar me të dhënat e normës klimatike (referuar periudhës 1961-1990) u mundësuan disa vlerësime në lidhje me ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet.


TEMPERATURA E AJRIT

Sa i takon temperaturave të ajrit duhet nënvizuar se për shkak të pranisë së masave ajrore me temperatura më të larta dhe një qëndrueshmërie atmosferike me një kohëzgjatje më të madhe, në territorin e vendit tonë gjatë muajit mars 2017 u shënuan temperatura rreth 2°C deri 4°C më të larta se norma. Duket qartë kjo pasqyrohet dhe në grafikun në vijim me të dhënat për 23 vendmatje, ku evidentohet pothuajse në të gjitha vendmatjet kjo dukuri.



RESHJET ATMOSFERIKE


Reshjet atmosferike regjistruan vlera më të ulta se norma në shumicën e vendmatjeve meteorologjike në territorin e vendit tonë. Në tërësi ato arritën deri në 56% të vlerave të normës. Në grafikun në vijim jepet një pasqyrë më e plotë për ecurinë e reshjeve në një 29 vendmatje meteorologjike të shtrira në të gjithë territorin e vendit tonë.




VLERËSIME MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM.

TEMPERATURA E AJRIT

Parashikimi sezonal për periudhat tremujore në vijim mban në konsideratë qarkullimin e përgjithshëm të atmosferës, mjaft elementë të tjerë të rëndësishëm meteorologjik si dhe zhvillimet e dukurisë “El Ninjo”, influenza e së cilës del më në pah në periudhën korrik - shtator. Një tendencë me temperatura lehtësisht mbi normalen parashikohet në shkallë të gjerë dhe mbi kontinentin europian. Deri më tani vlerësimet dhe probabilitetet janë më të larta për patur vlera temperaturash të ajrit mbi normë në të 4 stinët në vijim.




RESHJET ATMOSFERIKE



INFORMACIONE TË TJERA

Dita Botërore e Meteorologjisë: 23 mars 2017.

Retë luajnë një rol të rëndësishëm në parashikim e motit dhe në vlerësimin e klimës. Tema e Ditës Botërore të Meteorologjisë 23 mars 2017 ju dedikua Reve. Një njohje më e mirë e tyre paraqet një rëndësi të veçantë në vlerësimet klimatike, parashikimin e motit dhe vlerësimin e burimeve ujore. Deri më sot retë paraqiten si një element kyç ende i paqartë në rolin sa i takon studimeve mbi ndryshimet klimatike. Në ditët e sotme paraqitet me mjaft interes çështja për të



kuptuar më mirë se si retë influencojnë klimën dhe ndërkohë si ndryshimet klimatike prekin retë. Retë paraqesin një rol kyç në ciklin e qarkullimit të ujit në sistemin Tokë-Atmosferë si dhe në shpërndarjen e burimeve ujore në shkallë globale. Dita Botërore e Meteorologjisë këtë vit shënon dhe publikimin e një atlasit të ri ndërkombëtar për retë. Në këtë publikim përmbahen qindra foto sipas klasifikimit të njohur të reve, ku përfshihen dhe tipet e reja. Ky atlas përbën një burim informacioni profesional për të gjithë të interesuarit në këtë fushë, në veçanti për komunitetin e meteorologëve si dhe ata që punojnë në sektorët përkatës të aviacionit dhe transportit detar. Nga një pikëpamje tjetër artistike, Dita Botërore e Meteorologjisë këtë vit ofroi mundësinë që të evidentonin në kuadër të kësaj tematike, bukuritë frymëzuese të reve, të cilat janë përcjellë dhe kanë frymëzuar artistë, poetë, muzikantë, fotografë dhe amatorë ndër shekuj në historinë e njerëzimit. Përparimet në shkencë, teknologji dhe fotografi i dhanë mundësi OBM të ndërmarrë këtë detyrë ambicioze për të prodhuar një atlas të rinovuar me përfshirjen e pamjeve më të reja, falë dhe ndihmesës së pakursyer të meteorologëve dhe fotografëve nga mbarë bota. Versionin elektronik të këtij atlasit e gjeni në faqen e internetit në vijim:

[<https://www.wmocloudatlas.org/home.html>].



Retë Cirrus, janë re të katit të sipërm. Ato përbëhen nga kristale akulli. Këto re janë të holla, transparente, nuk krijojnë hije dhe janë me ngjyrë të bardhë. Dielli duket nën shtresën e tyre. Prej këtyre reve përgjithësisht nuk bien reshje, por edhe kur vrojtohen ato nuk arrijnë deri në sipërfaqe pasi avullojnë gjatë rënies.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.



<http://www.geo.edu.al>



Ky “Buletin Mujor Klimatik” u përgatit nga
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2017.

